



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr 13 prot
Date 22.05.2024

VENDIM

Nr. 8, datë 20.05.2024

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK”, TË
SHOQËRISË “TPLANI HC” SH.P.K.**



Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:


1. Miratimin e lejes “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik” nëpërmjet HEC VALBONA, të shoqërisë koncesionare “TPLANI HC” sh.p.k., me vendndodhje: në lumin e Valbonës, Njësia Administrative Margegaj, Bashkia Tropojë.

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC “VALBONA”

Vepra e marrjes, (KRGJSH):

- X= 491979
- Y= 4702462
- Z= 865 m.m.n.d



- $Q_{\text{mes-vjet}} = 3.47 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{\text{llog}} = 3.5 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{\text{eko}} = 0.11 \text{ m}^3/\text{s}$

Godina e Centralit:

- X= 492863
- Y= 4702925
- Z= 824 m.m.n.d
- Fuqia e instaluar 2300 kW
- Energjia Vjetore E=11 028 240 kWh/vit.

2. Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim hidroenergjetik jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3. Subjekti është i detyruar pas një kohe të shkurtër të bëjë instalimin estacionit hidrologjik pranë veprës së marrjes si dhe stacionit meteorologjik pranë godinës së centralit dhe të dhënat ti dërgojë pranë AMBU-së.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

